



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

NR. 113 DT. 14/12/2023



**“ PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 DHE
BUXHETIT VJETOR 2024”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 14.12.2023 pasi shqyrtoi materialin e relatuar nga Kryetari i Bashkisë “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”, në mbështetje të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar , ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 68/2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit nr 7961/1995 “Kodi i Punës në RSH” i ndryshuar, ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri”, ligjit 79/2017 “Për sportin”, ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e pushtetit vendor”, Udhëzimit plotësues nr 21, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, Udhëzimit nr 6, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, VKB nr 18, datë 28.02.2023 “Për miratimin e të ardhurave afatmesme 2024-2026 në Bashkinë Gjirokastrë”, VKM-së nr 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-së nr 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” VKM-së nr 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM-së nr 240, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr 350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, VKM-së nr 241, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM-në nr 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, VKM-së nr 242, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM-në nr 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, VKM-së nr 625, datë 28.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave për grupimin e njësive

të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

VENDOSI:

1. Të miratojë programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 sipas dokumentit bashëkgjitur.
2. Të miratojë buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024 sipas përcaktimit të nentit 40, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
3. Të mirtoj treguesit e buxhetit 2024 si më poshtë

I

A- Të ardhura gjithësej	809 275
A.1 Të ardhurat e veta të planifikuara për 2023.....	268 100
B- Transferta gjithësej.....	541 175
B.1 Transferta e përgjithshme e pakushtëzuar.....	285 728
B.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale.....	255 447


II

A- Shpenzime personeli.....	507 087
B- Shpenzime mallra dhe shërbime.....	173 284
C- Fondi rezervë.....	4 046
D- Fondi kontigjencës.....	4 046
E- Fondi emergjencës nga të ardhurat e veta.....	7 092
F- Shpenzime kapitale.....	113 720

4. Për kompetencë të kryetarit të bashkisë
 - a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program.
 - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve koherente, brenda të njëjtit program, (600-601-602).
 - c) Përdorimi i fondit të veçant sipas legjislacionit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo



Kryetari i Këshillit Bashkiak

Merita Isaraj

